



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Nr.03/

Datë: 05.12.2016

Aktvendimet e Kryetarit të Komunës së Malishevës- për muajin nëntor 2016

1. Aktvendim me nr. të prot.01/1326, miratohet pjesërisht kërkesa me nr.01/1263, dt.18.10.2016, e parashtruar nga Bekim Sertolli, nga fshati Bellanicë, për mbulimin e shpenzimeve për furnizim me barna pa pagesë për shërimin e djalit që vuan nga epilepsia.
2. Aktvendim me nr. të prot.01/1323, të inicohen procedurat e prokurimit publik, për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në lidhje me përzgjedhjen e operatorit ekonomik, për realizimin e projektit „ Rregullimi i rrugës Shkozë –Janqist” KK- Malishevë.
3. Aktvendim me nr. të prot.01/1322, të zotohen mjetet në shumë prej 980.00 euro, për renovimin e kulmit të palestrës sportive „ Habib Zogaj ” në Malishevë.
4. Aktvendimi me nr. të prot.01/1321, të zotohen mjetet në shumë prej 991.30 euro, mjetet lejohen në emër të renovimit të gypit furnizues në palestrën sportive „ Habib Zogaj”.
5. Aktvendim me nr. të prot.01/1320, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm, përkatësisht menaxheri i projektit në lidhje me realizimin e projektit asfaltimi i rrugëve fshatrat Pagarushë, Banjë, Maxharrë, Panorc dhe Shkozë.
6. Aktvendimi me nr. të prot.01/1319, të zotohen mjetet në shumë prej 3,320.00 euro, mjetet lejohen në emër të punimit të bazamentit dhe vendosjes së pllakës së Dëshmorit „Habib Zogaj” në oborrin e palestrës së sporteve në Malishevë.
7. Aktvendimi me nr.01/1318, lejohen mjetet financiare në shumë prej 990.00 euro, mjetet lejohen në emër të rrënimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Berishë.
8. Aktvendimi me nr. të prot.01/1317, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë së urbanizmit, në shumë prej 2,604.50, lidhur me realizimin e projektit rregullimi i ndriçimit publik në Malishevë, në lagjen e „ Matoshëve”, rrugën „William Voker”, dhe në fshatin Bellanicë dhe Kijevë.
9. Aktvendimi me nr. të prot.01/1315, lejohen mjetet financiare në shumë prej 628,74 euro, mjetet lejohen në emër të servisimit të automjetit zyrtar sanitar 07-467-BF, i cili është në shërbim të QKMF-së „Shpëtim Robaj” në Malishevë.
10. Aktvendimi me nr. të prot.01/1368, lejohen mjetet financiare në shumë prej 600.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit dhe mirëmbajtjes së internetit të administratës së KK- të Malishevës.
11. Aktvendimi me nr. të prot.01/1369, miratohet kërkesa nr.10/64, dt.10.11.2016, e parashtruar nga drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, në lidhje me fatkeqësit natyrore, për vlerësimin e dëmeve në Komunën e Malishevës.
12. Aktvendimi me nr. të prot.01/1362, për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural.

13. Aktvendim me nr. të prot.01/1352, miratohet aktvendimi për shkarkimin e Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
14. Aktvendimi me nr. të prot.01/1347, lejohet pushimi vjetor për z. Milaim Kastrati, pushimin vjetor prej 18 ditësh.
15. Aktvendim me nr. të prot.01/1345, miratohet kërkesa e drejtorisë së arsimit për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për marrjen e lejes për vulat për nevoja të kësaj drejtorie.
16. Aktvendimi me nr. të prot.01/1344, lejohen mjetet në shumë prej 660.00 euro, mjetet lejohen në emër të organizimit të transportit për pjesëmarrje e nxënësve në garat e gjuhës angleze në kolegjin „Mehmet Akif” në komunën e Lipjanit.
17. Aktvendimi me nr. të prot.01/1343, lejohen mjetet financiare në shumë prej 995.00 euro, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, në emër të furnizimit me material teknik për nevoja të shkollave fillore dhe të mesme që menaxhohen nga drejtoria komunale për arsim dhe edukim.
18. Aktvendim me nr. të prot.01/1340, miratohet propozimi për themelimin e grupit për vlerësimin e përformancës komunale, nr.01/1312, dt.03.11.2016, parashtruar sipas koordinatorit të emëruar me aktin nr.01/1260, dt.18.10.2016.
19. Aktvendim me nr. të prot.01/1339, miratohet ndryshimi i pozicioneve të projektit „ Punimi i kanalizimit në fshatrat Vërmicë, Turjakë, Drenoc dhe Malishevë, sipas kontratës nr.19 dhe numër të prokurimit nr.6250016038521.
20. Aktvendimi me nr. të prot. 01/1337, lejohen mjetet financiare në shumë prej 981.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me kupa sportive, për nevoja të drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sportit të KK- Malishevë.
21. Aktvendimi me nr. të prot.01/1338, lejohen mjetet financiare në shumë prej 674.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me buqeta lulesh, për nevoja të drejtorisë për shërbime publike, si dhe shoqatat e dala nga lufta në Malishevë.
22. Aktvendimi me nr. të prot.01/1336, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit publik, lidhur me furnizimin me inventarë për nevoja të administratës së KK- të Malishevës. Mjetet lejohen sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria për ekonomi dhe financa dhe buxhet.
23. Aktvendim me nr. të prot.01/1335, miratohet ndryshimi i pozicioneve me rastin e realizimit të projektit të rrethojës së objektit të QKMF-së „Shpëtim Robaj ” , sipas njoftimit nr.05/403, dt.27.10.2016, të bërë nga menaxheri i projektit të lartcekur.
24. Aktvendim me nr. të prot.01/1331, formohet komisioni për rregullimin e punimeve të projektit „ Rregullimi i ndriçimit publik në Malishevë në lagjen „ Matoshi ” dhe në rrugën „William Voker ”, në fshatin Kijevë, sipas prokurimit 62500.16.148.221, dhe kontratë me nr.68, të datës 27.10.2016
25. Aktvendimi me nr. 01/1072, lejohen mjetet financiare prej 200.00 euro, mjetet lejohen në emër të miratimit të kërkesës nr.01/1072, dt.06.09.2016, e parashtruar nga z.Aziz Morina nga fshati Golluboc, KK- Malishevës. Mjetet ndahen në emër të ndihmës momentale.
26. Aktvendimi me nr. të prot.01/1374, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet të drejtorisë për urbanizëm, përkatësisht menaxheri i projektit në lidhje me realizimin e projektit në kanalizimin e fshatit Marali, dhe qytezën e Malishevës sipas prokurimit nr.62500.16.0143.532 dhe arsyeshmëria e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm.

27. Aktvendimi me nr. të prot.01/1375, mjetet lejohen në emër të furnizimit me material teknik për mirëmbajtje për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme të cilat janë në menaxhim të DKAE-së, në KK të Malishevës. Mjetet financiare lejohen në shumë prej 16,000.00 euro.
28. Aktvendim me nr. të prot.01/1342, refuzohet kërkesa me nr.01/1342, dt.08.11.2016, parashtruar nga z. Feim Kastrati, menaxher drejtues i subjektit afarist „ Feim Kastrati” me seli në fshatin Mirushë, KK- Malishevë.
29. Aktvendimi me nr. të prot.01/1311, refuzohet kërkesa nr.01/1311, dt.02.11.2016, e parashtruar nga drejtoria për ekonomi dhe financa me kërkesë nr.04/69, dt.28.10.2016, e parashtruar nga SH.A. „EURO FAMIS”, Suharekë.
30. Aktvendimi me nr. të prot.01/1328, refuzohet kërkesa nr.01/1328, dt.07.11.2016, e parashtruar nga z. Visar Shurdhaj, menaxheri drejtues i subjektit afarist „ Blendi”, me seli në Malishevë, KK- Malishevë.
31. Aktvendimi me nr. të prot.01/1376, lejohen mjetet financiare në shumë prej 209.00 euro, mjetet lejohen në emër të mëditjeve zyrtare me rastin e pjesëmarrjes në trajnimin e organizuar nga Ministria për administrim e pushtetit lokal, Ftesa nr.06/1436, dt.19.10.2016.
32. Aktvendimi me nr. të prot.01/1377, lejohen mjete financiare në shumë prej 966.42 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me bateri dhe mbushës për nevojat e paisjeve gjeodezike, sipas kërkesës së drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër dhe shërbime pronëso-ro-juridike, në kuadër të KK- Malishevë.
33. Aktvendimi me nr. të prot.01/1372, lejohen mjetet prej 440.00 euro, mjetet në emër të organizimit të transportit për pjesëmarrje në gara të lëndës së kimisë të cilat do të mbahen në kolegjin „ Mehmet Akif” në komunën e Lipjanit.
34. Aktvendimi me nr. të prot.01/1370, lejohen mjetet financiare në shumë prej 500.00 euro, lejohen mjetet në emër të ndihmës për familjen e z. Avdi Hoxha nga fshati Gollubovc, për tejkalimin e gjendjes së vështirë ekonomike, sociale dhe shëndetësore.
35. Aktvendimi me nr. të prot.01/1405, për shfrytëzimin e pushimit vjetor, për z. Feim Krasniqi nga Carralluka, KK të Malishevës, i sistemuar në punë dhe detyra të punës zjarrfikës në ZHZSH.
36. Aktvendimi me nr. të prot. 01/1402, lejohen mjetet financiare në shumë prej 407.50 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me pije me rastin e mbajtjes së testit të arritshmërisë, të organizuar nga drejtoria e arsimit dhe edukimit, KK- Malishevë.
37. Aktvendimi me nr. të prot.01/1398, lejohen mjetet financiare në shumë prej 560.00 euro, mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije të bëra me rastin e organizimit të festivalit „ Oda e Llapushës”, në Komunën e Malishevës.
38. Aktvendimi me nr. të prot.01/1397, lejohen mjetet financiare në shumë prej 440.00 euro, mjetet lejohen në emër të organizimit të realizimit të vizitës dhe takimeve zyrtare me autoritetet arsimore të shkollave tetëvjeçare „ Tahir Sinani” në Tiranë.
39. Aktvendimi me nr. të prot.01/1413, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 698.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit emergjent me material të nevojshëm për familjet të cilat janë dëmtuar nga vërshimet gjatë muajit nëntor, në komunën e Malishevës.
40. Aktvendimi me nr. të prot.01/1414, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet në emër të mirëmbajtjes së fotokopjeve për institucionet arsimore që menaxhohen nga drejtoria komunale për arsim dhe edukim në Malishevë.

41. Aktvendimi me nr. të prot.01/1415, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 998.00 euro, në emër të furnizimit me letër për nevoja të institucioneve arsimore.
42. Aktvendim me nr. të prot.01/1416, për formimin e komisionit për verifikimin e punimeve të projektit, ndërtimi i trotuareve në lagjen e Gurit në Malishevë, në fshatin Drenoc, dhe ndërtimi i trotuarit që lidhë fshatrat Dragobil-Astrazup, sipas prokurimit 62500.16.054521, kërkesë nr.05/412 dt.01/11/2016.
43. Aktvendim me nr. të prot.01/1417, për formimin e komisionit për verifikimin e punimeve të projekti; Renovimi i kanalizimeve në komunën e Malishevës, me nr.prokurimit 62500.16.016.521, sipas kërkesës nr. 05/408, dt.14.10.2016.
44. Aktvendim me nr. të prot.01/1418, për formimin e komisionit për verifikimin e punimeve të projektit, ndërtimi i aneksit të objektit të administratës së KK-Malishevës, sipas prokurimit nr.62500.16.085.521, kërkesa nr.05/390, dt.24.10.2016.
45. Aktvendimi me nr. të prot.01/1409, lejohen mjetet financiare në shumë prej 920.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me ftesa, mirënjohje, njoftime dhe reklama, për nevoja të drejtorisë për kulturë, rini dhe sport.
46. Aktvendimi me nr. të prot.01/1446, lejohen mjetet financiare në shumë prej 970.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me material hargjuesë administrative, për nevojat e QKMF-së, në Malishevë.
47. Aktvendimi me nr. të prot.01/1445, lejohen mjetet financiare në shumë prej 420.30 euro, mjetet lejohen në emër të servisimit të veturës zyrtare „Passat” me numër të regjistrimit 07Z-04-30, e cila është në pronësi të administratës së KK- Malishevë.
48. Aktvendimi me nr. të prot.01/1444, lejohen mjetet financiare në shumë prej 685.00 euro, mjetet lejohen në emër të sigurimit, taksa e kontrollit teknik, taksa rrugore dhe shërbimi me rastin e regjistrimit të automjetit zyrtar „Mercedes” me targa 07Z-03-30, dhe „KIA” me numër 07Z-02-30, të cilat janë në shërbim të administratës së KK- Malishevë.
49. Aktvendimi me nr. të prot.01/1443, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë së urbanizimit, përkatësisht menaxheri i projektit punimi dhe shtruarja me kubëza e rrugëve në fshatin Bardhë.
50. Aktvendimi me nr. të prot.01/1434, iniciimi i procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 7,339.50 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit shtesë me material dhe ndërtimi i shtëpive të banimit për familjet e pastrehë, në komunën e Malishevës,
51. Aktvendimi me nr. të prot.01/1432, lejohen mjetet financiare në shumë prej 970.00 euro, mjetet lejohen për blerjen e dhuratave dhe shpërndarjen e tyre për festat e fundvitit.
52. Aktvendimi me nr. të prot. 01/1431, lejohen mjetet financiare në shumë prej 990.00 euro, lejohen mjetet në emër të OJQ-së, Fryma e të Rinjëve Malishevas për projektin, si të mbrohemi nga rreziku i vërshimeve.
53. Aktvendimi me nr. të prot.01/1396, lejohen mjetet financiare në shumë prej 300.00 euro, mjetet lejohen në emër të miratimit të kërkesës nr.01/1371, dt.17.11.2016, e parashtruar nga Sejdi Hoti nga fshati Carrallukë, KK- Malishevë, ndihma i ndahet me rastin e humbjes së anëtarit të familjes.
54. Aktvendimi me nr. të prot.01/1395, lejohen mjetet financiare në shumë prej 13.000.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me instrument të quajtur „Total Station”, sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria e kadastrit dhe gjeodezisë dhe shërbimeve pronësore juridike, në KK të Malishevës.

55. Aktvendimi me nr. të prot.01/1394, lejohen mjetet financiare në shumë prej 998.00 euro, mjetet lejohen sipas kërkesës së drejtorisë së shërbimeve publike, në kuadër të KK të Malishevës, lidhur me ndriçimin publik në lagjen e Mirëditës, KK – Malishevë.
56. Aktvendimi me nr. të prot.01/1393, për formimin e komisionit për verifikimin e punimeve të projektit; punimi i kanalizimit në fshatin Banjë në lagjen Binishi.
57. Aktvendimi me nr. të prot.01/1392, formohet komisioni për verifikimin e punimeve të projektit; Asfaltimi i rrugës në lagjen Shurdhaj në fshatin Banjë dhe në fshatin Gurishtë.
58. Aktvendimi me nr. të prot.01/1391, lejohen mjetet financiare në shumë prej 950.00 euro, mjetet lejohen në emër të realizimit të kërkesës dt.04.11.2016, në lidhje me përkrahjen financiare për shoqatën e grave „Fatjona”, për realizimin e panairit të prodhimeve bujqësore në Malishevë.
59. Aktvendimi me nr.01/1390, lejohen mjetet financiare në shumë prej 940.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me flamuj standard kombëtar sipas kërkesës së drejtorisë për shërbime publike.
60. Aktvendimi me nr. të prot.01/1389, lejohen mjetet financiare në shumë prej 9,900.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me pako ushqimore për familjet skamnore, për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve në komunën e Malishevës, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.
61. Aktvendimi me nr. të prot.01/1341, lejohen mjetet financiare në shumë prej 200.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me paisje për internet për nevoja të qendrës për punë sociale, në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, KK –Malishevë.
62. Aktvendimi me nr. të prot.01/1388, lejohen mjetet financiare në shumë prej 163.20 euro, mjetet lejohen në emër të avancit për mëditje jashtë vendit për katër ditë, për kryetarin e komunës së Malishevës, për pjesëmarrje në „ International Brand Cities Summit and Eurasia Urban Expo”, në Stamboll të Turqisë.
63. Aktvendimi me nr. të prot.01/1387, lejohen mjetet financiare në shumë prej 870.00 euro, mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije të krijuara me rastin e kremtimit të 7 marsit 2016.
64. Aktvendimi me nr. të prot.01/1384, ricaktohet Haxhi Krasniqi në vendin e punës certifikues – aprovues në Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit nga 23.11.2016.
65. Aktvendimi me nr. të prot.01/1383, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm, përkatësisht menaxheri i projektit në lidhje me realizimin e projektit, punimi i rrethojës së objektit zjarrëfikjes dhe shpëtimit në kuadër të drejtorisë dhe shpëtimit.
66. Aktvendimi me nr. të prot.01/1410, lejohen mjetet financiare në shumë prej 170,00 euro, mjetet lejohen në emër të rregullimit të derës së hyrjes në oborrin e objektit të Kuvendit Komunal. Mjetet lejohen sipas kërkesës së drejtorisë së administratës dt.17.11.2016.
67. Aktvendimi me nr.01/1411, formohet komisioni për verifikimin e punimeve të projektit: Rregullimi i rrethojës së objektit të SHZSH-së në Malishevë, sipas kërkesës nr. 05/498, dt.22.11.2016.

Malishevë, 05.12.2016

